



MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 428 Prot.

Tiranë, më 19.04 2016

**VENDIM Nr. 22, datë 13.04.2016**

Në mbështetje të **Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore"** (i ndryshuar), **VKM Nr. 725, datë 21.05.2008** "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"(i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4 të datës 13.04.2016, pasi shqyrtoi Informacionin mbi verifikimin në terren, në kuadër të **Projektit "Pikë karburanti me pakicë, ambiente shërbimi dhe lavazh, Paskuqan, Kamëz"**- Subjekti "KASTRATI" SH.P.K., realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Informacionin mbi verifikimin në terren, në kuadër të **Projektit "Pikë karburanti me pakicë, ambiente shërbimi dhe lavazh, Paskuqan, Kamëz"**- Subjekti "KASTRATI" SH.P.K., realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
2. Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikqyrja arkeologjike nga DRKK Durrës, e cila duhet të depozitohet pranë Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dokumentacionin për të, duke lidhur më parë aktmarrëveshje tre palëshe me ASHA dhe investitorin, sipas vendimit të KKA Nr. 102, datë 1.09.2015.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)